



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
KRYETARI

Nr. 3050 prot.

Tiranë më 19 . 04 .2021

URDHËR

Nr. 123 , datë 19 . 04 .2021

MBI ZHVILLIMIN E GJYKIMEVE TË KËRKESAVE PËR “LEJE VOTIMI”

Bazuar në nenin 26 dhe 37 të ligjit nr. 98 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” që përcaktojnë përkatësisht kompetencat e Kryetarit të Gjykatës dhe Zëvendëskryetarit, në nenin 25 që përcakton ndarjen e çështjeve me short si dhe nenin 57 të Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 74 datë 19.07.2012, Ligjin Nr. 31 datë 04.02.2015 si dhe Ligjin Nr. 101/2020, për të siguruar një proces normal të gjykimeve të kërkesave me objekt “Leje votimi”,

URDHËROJ

1. Gjykimin e kërkesave “Leje votimi” do të bëhet nga të gjithë gjyqtarët e Dhomës Civile, me përjashtim të gjyqtarëve të seksionit familjar, si dhe gjyqtarëve të cilëve ju është miratuar paraprakisht leja vjetore nga Kryetari i Gjykatës dhe/ose janë me raport mjekësor.
2. Kryesekretarinë në respektim të nenit 57 pika 1, i cili citon: “*Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve...*”, të pranojë regjistrimin e kërkesave të paraqitura deri në datën **23.04.2021 ora 24:00**, të cilat do të hidhen në short menjëherë sapo të paraqiten.
3. Shorti i këtyre kërkesave të afishohet në faqen elektronike të Gjykatës: www.gjykatatirana.gov.al, dhe listat në ambientet e jashtme të institucionit.
4. Sipas pikës 3 të nenit 57 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë i cili citon se: “*Gjykatat e rretheve gjyqësore shqyrtojnë dhe vendosin në lidhje me kërkesat, sipas pikës 1 të këtij neni, si në ditën e fundit para zgjedhjeve, edhe në ditën e zgjedhjeve, por jo më vonë se 6 orë përpara mbylljes së votimit...*”, gjyqtarët e dhomës civile si dhe administrata gjyqësore do të punojë edhe në ditët e pushimit, konkretisht datë **24 dhe 25 prill 2020**.

5. Ngarkohet Kancelari dhe Kryesekretaria e dhomës civile të marrin masat për krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e këtyre gjykimeve si dhe grafikun e punës për punonjësit e administratës.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR

PETRIT ÇOMO

